



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 6

Tiranë – E hënë, 19 shkurt 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë nr. 44/2, datë 14.2.2024	Për aplikimin e studentëve të interesuar për të përfituar nga skema e kreditimit studentor..... 3



NJOFTIM
Nr. 44/2, datë 14.2.2024

**PËR APLIKIMIN E STUDENTËVE TË
INTERESUAR PËR TË PËRFITUAR
NGA SKEMA E KREDITIMIT
STUDENTOR**

Në mbështetje të nenit 11, pika 1 “c”, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të germës “c”, të pikës 3 të VKM-së nr. 397, datë 3.5.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë”; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 19.7.2023, “Për përcaktimin e skemës së Kreditimit Studentor”, ju njoftojmë se:

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, fton studentët me shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri, që janë të regjistruar dhe ndjekin studimet në një institucion të arsimit të lartë publik, të aplikojnë për të përfituar nga skema e kreditimit studentor.

Sipas skemës së kreditimit studentor, studentët të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në VKM-në nr. 440/2023, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për kredi studentore, për financimin e kostove të studimeve. Kostoja e studimeve përfshin tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës, e cila përlllogaritet deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me vendimin të

Këshillit të Ministrave, në masën 40 000 lekë / muaj.

Kreditimi i studentëve do të realizohet nga banka e nivelit të dytë, e cila është përzgjedhur fituese nga AKFAL-ja, për të lidhur kontratë me studentët përfitues. Një pjesë e normës së interesit të kredisë (jo më shumë se pesë pikë përqindjeje) do të financohet nga buxheti i shtetit nga fondi për arsimin e lartë.

Renditja e aplikimeve të studentëve për kredi studentore do të bëhet nga komisioni që ngrihet nga AKFAL-ja, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në pikën 7, të VKM-së nr. 440/2023, të listuara si më poshtë:

1. Vlera e kredisë së kërkuar;
2. Lloji i programit të studimit ku është regjistruar studenti;
3. Rezultatet e studentit kërkuar për kredi studentore.

Për sa më sipër:

Ftojme të gjithë studentët të aplikojnë në portalin *u-Albania*, duke plotësuar formularin e aplikimit për kredi studentore, dhe të dorëzojnë dokumentacionin dorazi nga data 15.2.2024, në adresë të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë; adresa: Rruga “Naim Frashëri”, nr. 37, Tiranë.

Studenti kërkuar duhet të dorëzojë fizikisht dokumentet, sipas anekseve më poshtë:

1. Aneksi 1: Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim;
2. Aneks 2: Deklaratë për vërtetësinë e të dhënave.



FORMULARI I APLIKIMIT PËR KREDI STUDENTORE

SEKSIONI A: TË DHËNAT E APLIKANTIT

NID*:	
Emri*:	
Atësia*:	
Mbiemri*:	
Datëlindja*:	
Shtetësia*:	
Vendbanimi*:	
Adresa e-mail:	
Numri i telefonit celular:	

SEKSIONI B: TË DHËNAT MBI STUDIMIN

Institucioni i arsimit të lartë*:							
Lloji i institucionit:	☐ Publik ☐ Jopublik						
Programi i studimit*:							
Cikli i studimit*: Bachelor	☐						
Master	☐						
Program i integruar	☐						
Viti i studimit*:	<table><tr><td>☐ 1</td><td>☐ 2</td><td>☐ 3</td></tr><tr><td>☐ 4</td><td>☐ 5</td><td>☐ 6</td></tr></table>	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
☐ 1	☐ 2	☐ 3					
☐ 4	☐ 5	☐ 6					

SEKSIONI C: TË DHËNAT MBI KREDINË

Tarifa e studimit _____ lek/vit $\times$ _____ vite studimi = _____ lek

+

Kostot e jetesës _____ lek/muaj $\times$ _____ muaj = _____ lek

Shuma e kredisë*:

	LEK
{Tarifë studimi + Kostoja e jetesës}	



ANEKS 1

LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM

Kritere të përgjithshme të kualifikimit
1. Vërtetim që studenti ka shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri. 2. Vërtetim që studenti është regjistruar dhe ndjek studimet në një institucion publik të arsimit të lartë (nr. matrikullimi, lloji i programit të studimit) (dokument origjinal).
Kritere të veçanta të kualifikimit
1. Kopje të diplomës/dëftesës së pjekurisë + listë notash (vërtetim - listë notash të vitit paraardhës nga IAL-ja ku studion) (dokumente të noterizuara). 2. Vërtetim nga IAL-ja publike që nuk është përfitues i mbështetjes financiare/bursave/përrjashtim nga tarifa e studimit (dokument origjinal).

Në rast të mosplotësimit të një prej kritereve, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet.

E drejta e ankimit mund të ushtrohet nga studentët brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit dhe e shpalljes së renditjes nga Komisioni, në rrugë postare pranë AKFAL-së.

ANEKS 2

DEKLARATË PËR VËRTETËSINË E TË DHËNAVE

Unë i nënshkruari _____ (Emri Atësia Mbiemri) lindur më _____, me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ :

Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm, se në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Autorizoj MAS-in dhe/ose AKFAL-në për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim.

KËRKUESI

Emri Mbiemri Nënshkrimi

E-mail: _____

Nr. cel.: _____

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2024